



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, i ndryshuar”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për programin e reformimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës – faza II”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mhill Fufi

Të ftuar:

Milva Ekonomi - zëvendësministre e Shëndetësisë

Antoneta Njehrrëna - përgjegjëse e Sektorit Juridik në Drejtorinë e Burimeve
Mbështetëse në Ministrinë e Shëndetësisë

Ogerta Manastirliu - drejtore e Përgjithshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë
Tereza”

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit meqenëse formohet kuorumi.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, i ndryshuar”.

Dy deputetë të Kuvendit kanë paraqitur një ndryshim në këtë ligj.

Zonja Hysi, ju lutem, na bëni një paraqitje të këtyre ndryshimeve.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç jeni në dijeni, ne kemi bërë ndryshime në ligjin “Për nëpunësin civil”, por njëkohësisht edhe te Komisioneri i Shërbimit Civil, pra vendin e Komisionit të Shërbimit Civil tashmë e ka zënë komisioneri. Megjithatë është bërë ky ndryshim, në ligj nuk janë reflektuar ndryshimet që duhet të bëhen në lidhje me pagat, shpërblimet, strukturat e institucioneve të pavarura.

Në fakt, zoti kryetar, është një problem, sepse në shumicën e ligjeve që ne kemi ndryshuar duhet të jemi të vëmendshëm për të parë sesi ndikojnë në ligjet e tjera ligjet që ne ndryshojmë. E bëj këtë propozim për të bërë atë përmirësim që duhet në përputhje me ligjin “Për shërbimin civil”.

Në relacion është shpjeguar shkurtimisht arsyeja e këtij ndryshimi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Fino, si relator i këtij projektligji.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ashtu siç e tha edhe kolegja Hysi, ky ndryshim në projektligj është thjesht teknik. Në fakt, ne kemi pasur Komision të Shërbimit Civil, ndërkohë që e kemi zëvendësuar me ligj me Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Ne në ligj nuk kemi bërë ndryshimet për pagat, pra nuk kemi përcaktuar kategorinë e pagës për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, sepse nuk është njësoj me Komisionin e Shërbimit Civil. Kështu që klasifikimi “d”: “Emërimi i kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil”, do të zëvendësohet: “Emërimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil”. Në klasifikimin “e”: “Emërimi i anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil” do të shfuqizohet, sepse nuk kemi më anëtarë të Komisionit të Shërbimit Civil. Kjo është një praktikë, të cilën duhet ta paraqisim që në momentin kur u krijua

Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil. Pra, ky është një ndryshim që duhet të përshtatet dhe është thjesht teknik. Unë si relator i kësaj çështjeje jam plotësisht dakord që të kalojë.

Por çështja në të cilën këmbëngul edhe një herë është se (unë e kam ngritur edhe në seancë plenare dhe e di që i keni dhënë porosi edhe stafit, këshilltarëve në Komisionin e Ligjeve), ne duhet t'i shohim të gjitha strukturat që janë në varësi të parlamentit, institucionet e pavarura, për të rakorduar dhe dakordësuar bashkërisht për strukturën organizative. Në fakt, kjo nuk ka të bëjë me strukturën, por me pagat. Por, meqenëse po flasim për pagën, ne duhet ta shohim strukturën e të gjitha institucioneve të pavarura që janë në varësi të parlamentit, në funksion të asaj që duam t'i shohim bashkërisht. Problemi është: a duhet të kenë të gjitha institucionet sekretar të Përgjithshëm? Ne duhet t'i rregullojmë këto gjëra.

Dua edhe një herë vëmendjen tuaj dhe të stafit që në një kohë të shkurtër t'u paraqesë të gjithë anëtarëve të Komisionit të Ligjeve, por edhe ju, si kryetar, një dokument se çfarë bëhet me institucionet që janë në varësi të parlamentit dhe a janë strukturat e tyre të njësuara me ligjet e tjera që ne kemi ndryshuar. Në rastin konkret ne po bëjmë një ndryshim, të cilin duhet ta kishim bërë kohë më parë. Domethënë, duhet ta kishim bërë që në momentin kur parlamenti votoi ngritjen e Komisionit për Mbrojtjen e Shërbimit Civil dhe ka hequr Komisionin e Shërbimit Civil.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Jam dakord me shqetësimin tuaj koherent në lidhje me këtë çështje. Ky është një shqetësim i ligjshëm, që rezulton i tillë edhe nga raportet e herëpashershme të institucioneve të pavarura. Mendoj se kemi qenë konkretë në mbledhjen e mëparshme kur i kemi lënë një detyrë në një afat konkret Drejtorisë së Monitorimit dhe këshilltarëve të komisionit, që në kuadër edhe të Nënkomisionit për Administratën Publike të përgatisin një analizë dhe disa propozime konkrete për të njësuar dhe për të vendosur disa standarde të rëndësishme në strukturat e institucioneve të pavarura në nivelin e pagave dhe në mënyrën e funksionimit të tyre, sepse sot shumë institucione ndërtohen jo me fytyrën e ligjit dhe të nevojave që ka koha, por sipas shijeve të drejtuesve të tyre. Kjo praktikë duhet të marrë fund.

Zoti Klosi, keni fjalën.

Blendi Klosi – Unë e përshëndes zotin Fino për relacionin e tij dhe jam 100% dakord me të.

Si pjesëmarrës i Nënkomisionit të Administratës Publike mendoj që ky nënkomision duhet të aktivizohet më shumë dhe materiale të tilla të kalojnë nëpërmjet këtij nënkomisioni. Relatorët ose personat që ndjekin këto çështje duhet të jenë pjesë e këtij nënkomisioni.

Për sa i përket detyrës së dhënë, mendoj se është e nevojshme që të ketë një zyrtarizim apo ndërtim strukture mbështetëse për Nënkomisionin e Administratës Publike që të jetë aktive. Nëse është vetëm si pjesë e këtij komisioni, në rregull, por nëse duhet të kryejë rolin që ne menduam kur e votuam, duhet të jemi më konkretë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Klosi!

Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, që të mos mbetemi në kuadrin e fjalimeve që themi në parlament dhe në komision, unë dua që ju të vini një afat konkret. Nëse ne vazhdojmë kështu, atëherë le t'i drejtohem sekretares së Përgjithshme të Kuvendit për të monitoruar Drejtorinë e Monitorimit nëse e bën siç duhet punën apo jo. Kemi një muaj që diskutojmë për këtë çështje dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje konkrete me një letër në tavolinë, që të zgjidhë edhe shqetësimin që ka zoti Klosi, si nënkryetar e atij komisioni.

Për sa i përket relatorit, pak rëndësi ka nëse jam unë apo zoti Klosi, njësoj është.

Fatmir Xhafaj – Ai e kishte sugjerim dhe vërejte për drejtimin e komisionit, ishte i qartë.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Dakord.

Miratohet.

Neni 1? Dakord.

Miratohet.

Neni 2? Dakord.

Miratohet.

Neni 3? Dakord.

Miratohet.

Neni 4? Dakord.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Të gjithë dakord.

Miratohet.

Shumë faleminderit për mirëkuptimin!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.03.2015, ora 10:10

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për programin e reformimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës – faza II”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mhill Fufi

Të ftuar:

Milva Ekonomi - zëvendësministre e Shëndetësisë

Antoneta Njehrrëna - përgjegjëse e Sektorit Juridik në Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse në Ministrinë e Shëndetësisë

Ogerta Manastirliu - drejtore e Përgjithshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për programin e reformimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës – faza II”.

Zonja Ekonomi, ju lutem, na bëni një paraqitje të shkurtër të kësaj marrëveshjeje.

Milva Ekonomi – Mirëdita!

Unë dua t’ju bëj me dije që ne po negociojmë për të marrë këtë kredi, e cila do të mbështesë fazën e dytë të punimeve në QSUT. Në fazën e parë u realizua mundësia e ngritjes së një godine, me anë të një kredie prej 14 milionë eurosh, kontribut i BERZH-it. Ndërkohë qeveria shqiptare kontribuoi në blerjen e pajisjeve për fazën e parë.

Në ndërtimin që u bë në fazën e parë kanë mbetur ende dy hapësira, të cilat janë për të bërë një shërbim të ri në QSUT.

Kur BERZH-i erdhi në Shqipëri dhe e pa mënyrën sesi është punuar deri tani, bëri një vlerësim të situatës dhe ra dakord me palën shqiptare për të mundësuar plotësimin e këtyre dy kateve të reja të ndërtuara, për t’i shndërruar në salla kirurgjikale, si dhe për të transformuar Spitalin e Sëmundjeve të Brendshme.

Bashkë me këto kontribute BERZH-i do të japë edhe kontribute të tjera, që kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemit të informacionit në QSUT, si dhe disa konsulenca për të realizuar mënyrën sesi do të operohet gjatë periudhës që shtrihet ky projekt.

Ky projekt do të zgjasë rreth 36 muaj, ku mendohet të realizohen të gjitha punimet. Ndërkohë shumë e kredisë që ne do të marrim është 15 milionë e 930 mijë euro dhe ka një grant prej 1 milion e 500 mijë. Kontributi që jep qeveria shqiptare për këtë ndërtim është 30% e shumës totale, që është 7 milionë e 470 mijë euro. Ndërkohë kjo kredi është 20 vjet, brenda të cilëve kemi një periudhë 5-vjeçare që nuk do të paguajmë detyrime.

Me anë të kësaj kredie ne duam të përmirësojmë shërbimin në spitalin e vetëm universitar që kemi, sepse edhe fluksi i pacientëve që kërkojnë të ndiqen gjatë një periudhe vjetore është gjithmonë e më i lartë. Aktualisht ne kemi 65 mijë pacientë që trajtohen në vit, por nuk mjafton vetëm kjo. Në QSUT trajtohen në mënyrë ambulatorie shumë pacientë që vijnë nga e gjithë Shqipëria dhe numri është rreth 370 mijë.

Me këto dy investime ne mendojmë se po ecim në masterplanin që është rënë dakord që në 2005-n me BERZH-in dhe vazhdojmë të ndjekim detyrat e lëna nga qeveria prej kohësh për ta plotësuar më mirë shërbimin spitalor në vend.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zonja Caka, a keni ndonjë koment tjetër? Nuk keni.

A ka pyetje? Diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Dakord.

Miratohet.

Neni 1? Dakord.

Miratohet.

Neni 2? Dakord.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Dakord.

Miratohet.

Zonja zëvendësministre, faleminderit që ishit e pranishme!

Milva Ekonomi – Faleminderit për vëmendjen!

Fatmir Xhafaj – Meqenëse përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit nuk janë paraqitur, më vjen keq që ka ndodhur kjo gjë, e mbyllim këtu mbledhjen e komisionit dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për asistencën teknike për sistemin e ujësjellës-kanalizimeve” do ta shtyjmë për herën tjetër.

Faleminderit që ishit të pranishëm!

Mirupafshim dhe ditë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET

